

L

POEZIA

„Shpëtim Selmani në shkrimet e tij sjell fjali, ide dhe pamje të drejt-përdrejta të përditshmërisë së vrazhdë dhe shumëfish sfiduese për individin dhe kolektivitetin, me një zë herë thellësisht shpotitës, herë ironik e sarkastik, por që në instancën e fundit synon një katarsis shëlbyes të lirisë së shprehjes.

Shkëlzen Maliqi, Publicist.

„Unë e admiroj këtë zhbabë unike në një pegg të harruar. Unë e admiroj kreativitetin, intelegjencën dhe veçantinë e tij, pa dyshim. Unë e admiroj disiplinën e tij, njohuritë dhe shumëllojshmërinë e talentit të tij, natyrish. Por para së gjithash – unë e admirojë atë si një qenie me të vërtetë të mrekullueshme..

Vladimir Arsenijevic, Shkrimtar.

Një poezi

Jam Shpëtim Selmani.
Motherfucker i shkencës së njohjes njerëzore.
Endacak bastard i rrugëve ku u vra shpirti.
Dhe nderi. Dhe turpi. Dhe faji. Dhe arsyeja.
Po endem atypari.
Unë dhe macja
Pa sy e Edgar Allan Po-esë.
Ende kam mundësi të bëj marrëveshje
Të fshehura me veten.
E vetmja lumturi në duar.
Po merrem me teatër. Teatri
Tjetër, dhuratë nga perënditë
Është një shfaqje pa shije
E mbipopulluar nga aktorët e këqinjë.
Jam kundër të gjitha qeverive.
Jam kundër të gjitha bashkësive atdhetare.
Dhe lirisht mund ta përdhosni
Idenë time sakate, e cila qëndron e varur
Nëpër shtyllat elektrike.
Shkruaj poezi. Kohëve të fundit
Më duket se të gjitha janë të njëjta
Dhe habitem me veten pse nuk
Heq dorë nga kjo gjë.
Por kur ndalem e mendoj.
Mendja e qenies njerëzore
Është një shkëmb fanatik
Që duhet të cahet në dysh.
Kam vibrime të frikshme kur
Gjëra të liga më rrethojnë.
Në mes errësirës rri i heshtur,
Vështroj dhe ha thonjtë.
Jam romantiku i fundit
Hedhur si copë trëndafili
Në planetin e pajetueshëm.
Shel Silverstein është
Miku im më besnik,
Ngase nuk e njoha kurrë.
Jam Shpëtim Selmani.
Edhe nëse nuk do të isha
Nuk do të kishte farë rëndësi.
Fund e krye i rrahur nga
Grushtat e realitetit.
I dëbuar politikisht.
I urrey nga bombëkurdisësit.
I bekuar nga një grua
Dhe tragjikisht i zbatuar në
Fushën e madhe të prshitit.
Përgjithmonë hajvan vetmitar duke i dhënë
Botës dicka, për të cilën ajo nuk
Ka fare nevojë.
Një poezi.

Shpërthim

(për miqtë e zemrës, të katandisur)

Një shpërthim në zemrat e juaja të inatit.
Një shpërthim gjëmëmadr në Lindjen e Mesme.
Një shpërthim në ëndrën e kapitalizmit politik.
Një shpërthim në dhomat e gazetarëve cinik.
Një shpërthim në mendjet e hutura intelektuale.
Një shpërthim në plantacionet e bananeve në Ekuador.
Një shpërthim brenda mishit njerëzor dhunuar nga terroristët islamik.



Një shpërthim në burgjet e mbushura me vrasës.
Një shpërthim në Prishtinë.
Një shpërthim në Moskën e acaruar.
Një shpërthim në tokat e bekuara të Mesdheut.
Një shpërthim në spitalet psikiatrike.
Një shpërthim në teatrot e pislëkut.
Një shpërthim në gjoksin e drejtuesit të tankut,
Atij të automatikut dhe armikut të tij.
Një shpërthim në të gjitha gjokset e armiqve.
Një shpërthim në kokën e gazetashitësit,
Në kokën e gjeneralit dhe në kokën tënde të thjeshtë.
Një shpërthim në arsyen e konservatorit.
Një shpërthim në dorën e liberalit.
Një shpërthim në lumturinë e lypësit.
Një shpërthim i madh në shtratën e butë të të pasurve.
Një shpërthim në trupin e pemës.
Një shpërthim në instinktin e kafshës.
Një shpërthim në forcën e të mjerëve.
Një shpërthim në logjikën e mendjemadhit.
Një shpërthim tjetër në bezdinë e snobit.
Një shpërthim në gjinjtë e dashnoreve.
Një shpërthim në qiell.
Një shpërthim në gojën e ujku.
Një shpërthim në nëndetëset e mbushura me vdekje.
Një shpërthim në të gjitha bazat ushtarake.
Një shpërthim në flotat detare.
Një shpërthim në Korenë e kuqe.
Një shpërthim në të gjitha centralet bërthamore në Amerikë,
Rusi, Mbretërinë e Bashkuar, Francë, Kinë,
Indi, Pakistan, Izrael.
Një shpërthim në kasollet e pinguinëve.
Një shpërthim në të gjitha varret.
Një shpërthim në të gjitha forcat e të gjitha kombeve.
Një shpërthim në bibliotekën e mbretëreshës.
Një shpërthim në shpirtin e miqëve të mi të zemrës,
Benit, Xenit, Fadilit, Pjetrit, Danit, Agonit, Krenarit, Krapit,
Dritonit, Halilit, Jetonit, Mazrekut,
Milosit, Dusanit, Sashës, përsëri Sashës, Tomës, Zlatkos,

Vladimirit,
Brunos, John-it, Nick-ut, Bob-it, Tom-it, Leonardo-s.
Një shpërthim dashurie
Dhe asgjë tjetër.

Bleria me fundin e shkurtë dhe xhemperin e ngrohtë,
thotë se të gjithë ne jemi copëza të Zotit.
Bleria është copëza ime dhe meqenëse është copëza ime,
Del që jam copëzë e Zotit. Domsodoshmërisht teoria
E saj, na shpie në këtë konstatim.
Bleria thotë se jeta e bimëve është superiore
Dhe duke dashur që të jemi të përsosur para
Njërit tjetrit, ne synojmë të jemi qenie vegetative.
Bleria thotë se njeriu bëri shkëmbimin e instinktit
Me qëllimin dhe kuptimin e jetës.
Përderisa kafsha e arsyeton ekzistencën e saj
Ne si qenie superiore kemi shpikur vetëvrarsjen.
Por para njërit tjetrit ne e shpërfytyrojmë këtë akt,
Barbarisht si të vetmen çoroditje filozofike.
Dija jonë shkon deri në pikën e asgjësimit.
Mendja është masa e dhimbjes sonë shpirtërore
Dhe ndonjëherë fundi fizik i materies.
Ajo më thotë se kureshtja ime ka të bëjë me dhunën
Ndërsa kureshtja e saj gllabëron barishtet.
Bleria është butësia e tërfillt në erë.
Që ta dini se jam pjellë e shëmtuar romantike.
Them me aq zë që kam se
Ajo është lulehëna magjepsëse.
Ajo është luledielli sjellur nga kolonizatorët e duarve të buta.
Bleria që më puth supet në qoshet e Strip Depos,
E bukur në mënyrën e vet si një Orkide e Bardhë,
Rritur në orizoret e largëta.
Zambak i zjarrtë që djeg buqetën.
Që ta dini se jam fëlliqësira e fundit romantike.
Bleria është një lule që lulëzon një herë në jetë.

Ajo rritet në natë dhe mbyllet në agim.
Dhe e gjitha dita që shtrihet para
Syve të mi, nuk është asgjë tjetër pos
Një pritje që e trishton arsyen e Zotit,
Zhytur përgjumshëm në lëndën tonë,
Që i thurr sonete parasjës në
Barkun e nënës dhe daljes nga aty,
Ferrit.

Letër për Iggy Pop

Iggy.
Nuk e kam më asnjë poezi në xhep.
Nuk e kam më asnjë ide në kokë.
Nuk e kam më asnjë metelik në duar.
Asnjë gotë mbushur para meje.
Më ka marrë djalli.
Dhe prapë jam një fytyrë e lumtur.
Iggy.
Në flakë është çdo qeveri.
Në flakë është çdo komb.
Në flakë është çdo dashuri.
Në flakë është çdo mendimtar.
Më ka marrë djalli.
Nga truri më del një tym i cili
Mbulon të gjitha botërat.
Iggy.
Ka vec një gjë të njëmendtë.
Që duke mos e parë e besojmë.
Që duke mos e prekur e ndjëmë.
Ka vec një gjë të njëmendtë
Që një ditë do ta fus shijetën e saj
Hynore në zemrat tona të zeza,
Pafytyrësia e madhe e kohës.
Iggy.
Kur shoh njerëz në rrugë,
Rrugët bëhen të zbrazura.
Pakënaqësia është Zot.
Zoti është pakënaqësi.
Ne jemi një urë e kalbur.
Iggy.
Të gjithë jemi produkte
Farmaceutike që i shërbejmë
Njeri tjetrit. Të gjithë jemi
Qelbësira artistike. Të gjithë në duart
Tona kemi përgjigjet e vonuara,
Që më nuk i duhen as dreqit.
Iggy.
Muti është OK. Vuajtja është OK.
Sëmudjet janë OK. Vrasjet janë OK.
Religjioni është OK. Politika është OK.
Prijësit janë OK. Paaftësia është OK.
Bota është një O dhe ne jemi një K.
Iggy.
Letrat nuk kanë kuptim.
Dhe shpresoj që të tjera
Herë të mos kem një nevojë
Tjetër për të qenë sërish i
Pakuftueshëm.
Iggy. Të gjitha qeniet pak a shumë
Do të mbesin si palaço të ngrirë,
Pa asgjë rreth tyre.
Dhe pikërisht këtu, përfundon e gjithë dija ime.

Nuk jam një burrë i butë
Sado që mirësjelljen e kam në gjak.
Ka caste kur vetja më del nga duart
Dhe hap krahët për
Ta përqaftuar arrogancën,
Ka caste kur sjellja e keqe
Më bëhet mbijetesë.
Në këso lloj kohërash të sëmura,
Është e pamundur të rrih rehat,
Njerëzit do të sulen dhe do të fusin
Helm në zemrën tënde.

Mjerimi është pushtet.
Tjetri është një thikë e frikshme.
Dhe dashuritë, të pamjaftueshme.
Ec e thuaj dicka të bukur.
Ec e thuaj dicka njerëzore.
Ec e thuaj shkruaj një poemë.

Dhe sado që përpiqem ta kuptoj
Se cdo epokë ka qenë e kësajsojtë,
Se cdo epokë ka pasur shëmtinë,
Nuk i'a dal të qetësohem.
E ndjejë lëkurën time si kufi
Dhe botën e jashtme si shtypje.*

*Sipas Michel Houellebecq.

P PUBLICISTIKA

Çdo personazhi i paraprin portreti, i përshkruar saktë dhe tejet konkretisht nga autorja. Pastaj vjen rrëfimi. Në disa prej autorëve intervista është e pranishme Por në pjesën më të madhe, kemi gati rrëfimin linear të tyre. Ndoshta kjo e dëmton disi librin sepse zakonisht bejfa e pyetjes kërkon gjithnjë spontanitetin e përgjigjes, një gjë të cilën nuk e mundëson lidhja online...

Të kërkosh identitetin e vendit tënd duke intervistuar miqtë

NGA BENANDONI

Albana Shala zgjodhi të shtjellojë pyetjet e saj filozofike bazike përmes një bashkëbisedimi ose të themi një krijimi, që është një gjini e përzier mes intervistës dhe portretit, por edhe me eksperimentimin e futjes së teksteve alternative në rrëfim. Dhjetë miq të saj në periudha të ndryshme, pikërisht ata, që sipas autorese ia bëjnë atdheun më të prekshëm na vinë në këtë libër, që është botuar vetëm pak muaj më parë nga Carabela Books.

Dhjetë rrëfime të singërta të njerëzve të ndryshëm, nga ata me profile publike të njohura, por edhe ata krejtësisht të panjohur japin Shqipërinë nga këndvështrimet të shumta.

Po si mund ta gjykojmë mirë librin? Ka matrica kritike që mund të merrin me stilin. Ka të tjera, që duan të nxjerrin ndërgjegjen e argumentit të autorese për idenë e saj, por libri është thjeshtësisht i kapshëm për singëritetin e madh me të cilën ajo rrethon rrëfimin e dhjetë subjekteve të saj. Përmes tyre, lexuesi rrugëton në rrugë të ndryshme mbijetesë, suksesi, përshatje, por edhe jete të zakonshme. Larg miteve urbane, tejet më larg akoma falsitetit, Albana mundohet t'i grishë miqtë e saj të hapin sa më shumë cak-pamjen shqiptare dhe vendin e shqiptarit të sotëm në këtë realitet. E bindur se në Ballkan prodhohet më shumë histori sesa ka pasur në të vërtetë, autorja e shtrin fashën moshore të një brezi, që ka pasur shumë pjesë në fatet e Shqipërisë në shumë tema, që ajo i ngacmon përmes pyetjeve të saj.

Të gjitha kombet në botë kanë historinë e tyre, por edhe mitet dhe mitologjitë të cilat janë pjesë thelbësore e një shteti komb. Dallimi më i madh midis historisë dhe mitologjisë është se historia bazohet në fakte dhe prova, kurse mitet janë kryesisht tregime epike ose tregime shpesh herë rrëfime të pasakta historike, ku ballkanasit shtrijnë përçartjet e tyre të pamatshme.

Ku jemi dhe kah po shkojmë? Pyetjet e saj bazike na bëjnë të përsiasim



Albana Shala

sëbashku me këto personazhe se megjithatë jemi thjesht në kohë të arsyeshme, paqka se të gjithë e kumtojnë si një kohë pa asnjë logjikë. Edhe pse Albana mëton se personazhet e saj nuk janë aq të njohur, një pjesë e vogël e tyre janë

tejet publikë. Në këtë libër ata e tregojnë këtë më së miri, por edhe tepër simbolikisht jetën dhe formimin e një identiteti të ri të shqiptarëve të pas viteve '90, kohë kur Shqipëria po jeton në një sistem ekonomik-shoqëror, krejt të ndryshëm nga ai i 27 viteve më parë. Dhe në strukturën ideale të rrjetës, me të cilën ajo shpjegon metodikën e saj, hidhet për të kapur realisht pulsmin e Shqipërisë së sotme. "Që në 1870, i referohet një shkrimtare, znj. Shala, ajo përdorë metaforën e rrjetit për të përshkruar jetën në provincë kur shkruante: 'shoqëria është një rrjet, prej të cil-

it nuk mund të veçosh asnjë fije pa prekur gjithë të tjerat'.

Çdo personazhi i paraprin portreti, i përshkruar saktë dhe tejet konkretisht

nga autorja. Pastaj vjen rrëfimi. Në disa prej autorëve intervista është e pranishme Por në pjesën më të madhe, kemi gati rrëfimin linear të tyre. Ndoshta kjo e dëmton disi librin sepse zakonisht bejfa e pyetjes kërkon gjithnjë spontanitetin e përgjigjes, një gjë të cilën nuk e mundëson lidhja online. Anipse Albana vazhdon skrupuloze të nxjerrë personazhet e saj, që i masakron me zbirilimet e shumta, por edhe me ato sinteza që i shpyn të bëjnë personazhet e saj.

Në rastin e Eda Derhemit, njëres prej personazheve më interesante të saj, autorja futet me tekstin e saj, duke bërë të njohur pozicionin e miqsisë dhe adhurimin për personazhin, por edhe ndërkall letrën që Eda dikur bëri për vajzën e vet.

Po shkëpusim si shumë interesante atë që Eda i kumton për identitetin: "Identitetin unë e kuptoj si atë gjënë komplekse e të lëngshme që është secili, dhe që vjen pikërisht prej llojeve të ditëve, ngjarjeve, miqve, vendit, kohës që jetojmë, aqsa edhe prej vetive fizike e psikologjike intrinsike të personit. Të gjitha këto, si dukuritë me të cilat krenohemi (p.sh. afërsia me librin ose artin në fëmijëri), si ato të cilat nuk na pëlqen t'i zemë me gojë, si nevoja për të rëndur pas dickaje materiale, koincidenca fatkëqja, trauma të vegjëlisë, na bëjnë çfarë jemi dhe përcaktojmë identitetin tonë si diçka që s'ngjan me asgjë tjetër dhe përbën të vetmen gjë që çdo individ lë pas më gjithësinë shoqërore në formë kujtimesh e ndikimesh".

Dhe, në fund, përmes një epilogu, autorja na shpalos atë që do të kumtojë, shpresën për vendin e saj, që në këtë libër e lidh me këto rrëfime, ku përshfaqen mendime të thella të shumë prej personazheve të saj. Tek e fundit përmes kësaj lloj forme ka treguar sesi e përcaktojnë Shqipërinë personazhet e saj që janë bukur shumë njerëzit me të cilat Albana merr ekstraktin e atdheut të bukur, atë që e kemi të gjithë në përfytyrimet dhe dëshirat tona.



Titulli: Bisedë me dhjetë miq
Autor: Albana Shala
Gjinia: Portret
Botues: Carabela Books
Faqe: 202